



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:220923

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05846293

KPPP.nr.1480/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit "Petrol Company" sh.p.k., me NUI:810527195, me seli në Zonën Industriale Prishtinë- Fushë Kosovë, kundër debitorit "JOOS & KRASNIQI- BAZË" SH.P.K., me seli në Junik, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Taulant Hodaj avokat nga Prishtina Rr."Fehmi Agani" nr.79/8, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1234/21 të datës 09.09.2021 të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit "JOOS & KRASNIQI- BAZË" SH.P.K., me NUI:810962309, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.1234/21 të datës 09.09.2021 i Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, për pjesën e detyrimit në shumën prej 24,799.26 €.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit "JOOS & KRASNIQI- BAZË" SH.P.K., me NUI:810962309, ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.1234/21 të datës 09.09.2021 i Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, për pjesën e detyrimit në shumën prej 124,495.00 €.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit "Petrol Company" sh.p.k., me NUI:810527195, ndaj debitorit "JOOS & KRASNIQI- BAZË" SH.P.K., me NUI:810962309, sipas urdhrit P.nr.1234/21 të datës 09.09.2021 i Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, për pjesën e detyrimit në shumën prej 24,799.26 €.

- IV. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në shumë prej 124,495.00 euro.
- V. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.1234/21 të datës 09.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve të besueshme – Fatura me numër 445/21 e datës 02.03.2021, fatura me numër 446/21 e datës 03.03.2021, fatura me numër 447/21 e datës 04.03.2021, fatura me numër 516/21 e datës 09.03.2021, fatura me numër 1529/21 e datës 31.03.2021, fatura me numër 2009/21 e datës 30.04.2021, fatura me numër 1039/21 e datës 11.05.2021, fatura me numër 2600/21 e datës 31.05.2021, fatura me numër 3368/21 e datës 30.06.2021, ku e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj borxhin e mbetur në shumë prej 149,294.26 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e arritjes së kërkesës për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Me parashtrësën e datës 22.09.2021, ka bërë për precizimin e borxhit pasi që debitori me datën 25.03.2021, ka kryer pagesë në shumë prej 30.000.00 euro, për faturën me numër 445/21 e datës 02.03.2021, faturën me numër 446/21 e datës 03.03.2021, faturën me numër 447/21 e datës 04.03.2021, dhe për faturën me numër 516/21 të datës 09.03.2021, vetëm shumën prej 801.56 euro, kurse obligimi ka mbetur për këtë faturë në shumë prej 5,308.44 euro. Ashtu që pas verifikimit të bërë në bazë të faturave të lartcekura ka bërë precizimin e obligimit për lëndën përmbartimore me numër P.nr.1234/21, ku obligimi i debitorit është në vlerë prej 124,495.00 euro.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, ndër të tjerash ka theksuar se kreditori dhe debitori kanë bërë biznes ndërmjet veti, ku debitori është furnizuar me naftë dhe derivate të

naftës nga kreditori, për të cilat ka lëshuar faturat e cekura në paragrafin 1.1., e që sipas të njëjtit vlera totale e faturave që nuk është paguar arrin shumën prej 149,294.26 euro. Po ashtu kreditori me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarrim nuk e ka specifikuar se për cilën faturë debitori ka paguar shumën në vlerë prej 5,200.74 euro, mirëpo i njëjti vetëm i ka bashkangjitur të gjitha faturat. Ka shtuar se fatura me numër 1039 e datës 11.05.2021, ku e njëjta në këtë procedurë përmbarrimore nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga debitori dhe rrjedhimisht nuk është e përshtatshme për përmbarrim. Tutje ka theksuar se në bazë të kartelës financiare të debitorit të datës 15.09.2021, vërehet qartë se i njëjti ka kryer pagesa për kreditorin dhe atë në banka të ndryshme ku shuma e përgjithshme që debitori ka paguar vetëm gjatë vitit 2021 arrin shumën prej 150,000.00 euro, andaj e kundërshton kërkesën e kreditorit pasi që i njëjti nuk ka ofruar as edhe një provë të vetme se faturat kanë mbetur pa u paguar dhe po ashtu detyrimi i pretenduar nga kreditori nuk është real. Po ashtu ka theksuar se përmes komunikimeve që kanë pasur me e-mail, shihet qartë se me pajtimin e të dyja palëve kanë vendosur që të zgjatet afati i pagesës së faturave dhe të ketë mirëkuptim për vonesat. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës ta aprovoj prapësimin e debitorit, të anulohet urdhri përmbarrimor si dhe të obligohet kreditori që t'ia paguaj shumën prej 312 euro për përpilimin e prapësimin.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjera ka theksuar se thëniet në prapësim nuk përbëjnë bazë për kundërshtim dhe se kreditori me parashtruesën e datës 22.09.2021, ka bërë verifikimin e obligimit dhe ka njoftuar organin përmbarrues se e bënë precizimin e obligimit në shumë prej 124,495.00 euro. Ka shtuar se pretendimi kreditorit se fatura me numër 1039 e datës 11.05.2021, është e pa nënshkruar, nuk qëndron pasi që një gjë e tillë vërtetohet nga fatura e bashkangjitur në propozim. Tutje ka theksuar se zyrtarja kompetente e palës kredituese, nëpërmjet e-mailit të datës 06.09.2021, e ka njoftuar debitorin për rrugët përmbarrimore që do të ndiqte, në qoftë se debitori nuk do të bënte ndonjë pagesë për obligimet përkatëse ndaj kreditorit deri me datën 07.09.2021. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës ta refuzoj si të pa bazuar prapësimin dhe të aprovohet në tërësi urdhri përmbarrimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji

Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbartim dhe i lejuar me urdhrin e përmbartuesit privat është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit në shumë prej 30.000.00 euro, për faturën me numër 445/21 e datës 02.03.2021, faturën me numër 446/21 e datës 03.03.2021, faturën me numër 447/21 e datës 04.03.2021, dhe pjesërisht për faturën me numër 516/21 të datës 09.03.2021, vetëm shumën prej 801.56 euro, fakt ky që vërtetohet nga transferi bankar i datës 25.03.2021, i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Andaj Gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.8 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori me nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurës nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbjlljes së një ujdje gjyqësore ose një ujdje administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër;”* aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që kredia që rrjedh nga dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor, është shuar pjesërisht përmes përmbushjes së pjesshme nga ana e debitorit në shumën prej 24,799.26 €.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.1234/21 të datës 09.09.2021, për pjesën tjetër të detyrimit në shumë prej 124,495.00 €, për faktin se faturat e lartcekura i plotësojnë në tërësi kushtet për të qenë dokumente të besueshme si dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.* Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën

paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar pjesërisht detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit si rrjedhojë e përmbushjes së pjeshme të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa për pjesën tjetër përtej shumës së përmbushjes së detyrimit, dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata i vlerësoj pretendimet e tjera të palëve në këtë procedurë, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbartimore.

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën V, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t’ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 64 par.4, nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për

Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1480/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.